



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

RREGULLORE MBI TEMËN E DIPLOMËS

Programi i Studimit Master i Shkencave me Cikël të Integruar në “Arkitekturë”

- Në bazë të ligjit Nr 80 të datës 22.09.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë";
- Në bazë të Urdhrit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 531 datë 11.09.2018, në lidhje me Standardet mbi Sigurimin e Cilësisë në Programet e Studimit të Ciklit të Dytë të Integuara "Master I Shkencave";
- Në bazë të Statutit të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" (UKZKM);
- Bazuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara;
- Bazuar në Marrëveshjen ndërmjet Universitetit të Firencës / Departamentit të Arkitekturës (UNIFI / DIDA) dhe UCNSBC të datës 20.06.2018.

Vendoset

Rregullorja e Temës së Diplomës së Programit të Studimit Master i Shkencave me Cikël të Integruar në Arkitekturë

Neni 1 Përmbajtja

Ky dokument përmban rregullat për kryerjen e Temave të Diplomës nga studentë të regjistruar në UKZKM në programin Master i Shkencave me cikël të integruar në Arkitekturë, të cilët kanë grumbulluar kreditet e parashikuara nga marrëveshja, të miratuara më parë nga këshilli i programit, në Programin e Studimit të integruar Master në Arkitekturë LM-4 i Universitetit të Firences dhe gjithashtu nga Programi i Studimit i Masterit në Arkitekturë i miratuar nga Ministria Shqiptare me Urdhrin Nr. 247, datë 18/06/2015 korrigjuar Nr. 335 datë 16 /09/2015.

Këto rregulla janë në përputhje me dispozitat përkatëse të nxjerra nga UKZKM dhe UNIFI, si dhe nga Shkolla e Arkitekturës UNIFI.

Neni 2 Qëllimi

Këto rregullore synon të riafirmojnë rolin që i atribuohet historikisht temës së diplomës gjatë formimit të arkitektit.

Pikërisht për shkak të këtij roli, është kërkuar Tema e Diplomës, aty ku është e mundur, domethënë një përvojë me të cilën studenti mund të rivendosë me të vërtetë njohuritë e ndryshme që kontribuojnë në projektin arkitekturor.





UNIVERSITÀ CATTOLICA NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Neni 3 Relatori dhe Bashkërelatori

Për të përmbushur objektivat e përmendura në nenin 2, është e dëshirueshme që, në hartimin e punimit, së bashku me Relatorin (koordinatori i vërtetë i punës së tezës dhe udhëheqës i studentit që do të diplomohet), mund të përfshihen edhe bashkërelatorë të brendshëm që i përkasin Sektorëve Disiplinorë Shkencorë të ndryshëm nga të Relatorit, që hera-herës mund të konsiderohen më të rëndësishme për suksesin e punës së temës.

Me korrelatorin e brendshëm nënkuptojmë një pedagog të brendshëm ose të kontraktuar nga UKZKM dhe UNIFI / DIDA. Me gjykim të Relatorit, mund të përfshihen në raste të jashtëzakonshme edhe korelatorët e jashtëm.

Neni 4 Komisionet e Diplomës

Komisioni i Diplomës emërohet nga Rektori, me propozimin e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, dhe përbëhet nga jo më pak se shtatë anëtarë, nga të cilët të paktën pesë janë titullarë për mësimdhënien e lëndëve zyrtare të Fakultetit. Relatorët do të jenë pjesë e Komisionit të Diplomës, ndërsa bashkërelatorët mund të jenë të pranishëm në diskutimin e temës.

Komisioni i diplomave kryesohet nga Rektori ose Dekani i Fakultetit ose, në mungesë të tyre, nga personi i autorizuar prej tyre.

Neni 5 Tema e Diplomës

Temat e diplomës duhet të jenë individuale.

Pa paragjykuar parimin e njohjes së kontributit individual të secilit kandidat, e njëjta temë e Tezës mund të trajtohet, edhe në një formë të koordinuar, nga disa studentë njëkohësisht. Gjykimi i fundit dhe nota do të jenë gjithmonë individuale.

Neni 6 Llojet dhe koha e prezantimit të temave

Ekzistojnë tre lloje të paraqitjes të tezave:

- në formë shkresore (maksimumi 15 tabela), me një apo më tepër modele të pranuar;
- në formë shkresore (maksimumi 12 tabela) me projeksion përmes prezantimit / përfundimit, me pranimin e një ose më shumë modeleve;
- vetëm projektim apo vetëm prezantim me gojë.

Koha maksimale për prezantimin e temave është 35 minuta.





UNIVERSITÀ CATTOLICA NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Zgjatja e kohës maksimale të prezantimit mund të bëhet nga Kryetari i Komisionit në bazë të nevojave të veçanta.

Sezonet e diplomimit zakonisht mbahen në muajt prill, korrik dhe nëntor (ku sezoni i prillit është një sezon i jashtëzakonshëm i vitit akademik i mbyllur në tetorin e kaluar), në rast nevojash të veçanta.

Neni 7 Formati i temës së diplomës

Tema e Diplomës duhet të dorëzohet në italisht në dy kopje në formë shkresore dhe dixhitale në CD për UKZKM dhe UNIFI / DIDA.

Të gjitha kopjet duhet t'i dorëzohen Sekretarisë Mësimor të UKZKM të paktën 15 ditë para datës së caktuar për mbrojtjen.

Neni 8 Vlerësimi

Për të vlerësuar në mënyrë të duhur karrierën e studentit, dhe duke marrë parasysh numrin e ECTS-ve që i atribuohen Temave të Diplomës në Programin e Studimit në Arkitekturë, Komisioni mund t'i atribuojë një maksimum prej 10 pikësh temave më të mira.

Përcaktimi i rezultatit që do t'i jepet secilës tezë bëhet nga shumica e të pranishmëve. Kjo notë do të shtohet në mesataren e marrë nga studenti gjatë karrierës akademike dhe do të përbëjë notën e diplomimit.

Bashkërelatorët e jashtëm nuk merrin pjesë në caktimin e notës së diplomimit.

Me unanimitet vendoset edhe "shkëlqyeshëm" me propozimin e një Anëtari tjetër të Komisionit të ndryshëm nga Relatori apo Bashkërelatori.

Në rastin e temave të inovacionit dhe origjinalitetit të veçantë, mund të caktohet unanimisht me propozimin e një Anëtari të Komisionit, përveç Mbikëqyrësit dhe Mbikëqyrësit edhe publikimi i temës.

Neni 9 Përmbushje formale nga studenti që po diplomohet

Për tu pranuar në provimin e diplomimit, studenti i diplomuar duhet të paraqesë pranë Sekretarisë Mësimore të UKZKM të plotësuar dokumentet e mëposhtme:

- 1) Kërkesë për dorëzimin e temës (**Formular 1**), e nënshkruar nga Relatori dhe mundësisht edhe nga Bashkërelatori. Kërkesa duhet t'i drejtohet Dekanit të Fakultetit dhe të depozitohet në Sekretarinë Mësimore





UNIVERSITÀ CATTOLICA NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Për të paraqitur kërkesën për caktimin e një punimi të diplomës, studenti duhet të ketë kaluar provime kurrikulare duke marrë jo më pak se 200 ECTS dhe duhet të jetë në rregull me pagesën e tarifave të kërkuara.

- 2) Dy muaj para sezonit të diplomimit, studenti duhet të paraqesë kërkesën për pranim në provimin e diplomimit (**Formulari 2**), nënshkruar nga Relatori. Kërkesa për pranim duhet t'i drejtohet Rektorit të Nderuar të UKZKM dhe duhet të përfshijë kërkesën për arritjen e titullit të dyfishtë në përputhje me marrëveshjen në fuqi midis UKZKM dhe UNIFI / DIDA.

Një muaj para datës së diplomimit, studenti duhet të depozitojë pranë Sekretarisë Mësimore të UKZKM:

- Librezën e Universitetit
- Librezën dhe formularët me certifikatat e praktikës së zhvilluar
- Faturën e pagesës së tarifës së taksës për diplomën në UKZKM
- Deklaratë për bibliotekat
- Deklaratë nga Zyra e Financave për rregullsinë me pagesën e tarifave universitare
- Deklaratë e angazhimit për të paraqitur temën e shkruar në italisht në dy kopje 15 ditë para seancës së diplomimit.

Pranimi për të mbrojtur temën e diplomës vendoset nga **Komisioni i Përbashkët Teknik**, i emëruar nga Rektori me propozimin e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, i përbërë nga Koordinator i Programit të Studimit, një anëtar i Departamentit dhe i deleguari ose referenti kompetent për të ndjekur zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet UNIFI dhe UKZKM.

Për të vendosur miratimin e tezës, **Komisioni i Përbashkët Teknik** merr dokumentet e mëposhtme nga Sekretaria Mësimore UKZKM:

- Deklaratë për bibliotekat
- Formulari që tregon titullin e tezës
- Formulari i autorizimit / refuzimit të konsultimit
- Certifikatë e lëshuar nga Sekretaria Mësimore e UKZKM me datën e fillimit dhe mbarimit të Praktikës dhe emrin e studios / kompanisë ku u krye Praktika.
- Certifikatë e provimeve të kaluar dhe të vërtetuara nga UKZKM, me indikacion të provimeve të marra në UNIFI / DIDA (të paktën 60 kredite) dhe të çdo krediti të caktuar për temën nëse fillohet gjatë mobilitetit.

Neni 10 Detyrime formale nga sekretaria mësimore e studentëve të UKZKM dhe komisioni teknik i përbashkët

Komisioni i Përbashkët Teknik mbledh për të shqyrtuar dokumentet e përmendura në paragrafin e mëparshëm të depozituara në Sekretarinë Mësimore edhe në mënyrë elektronike. Konvalidimi duhet të bëhet të paktën 15 ditë para diskutimit të temës së diplomës.





UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Komisioni i Përbashkët Teknik thirret nga Koordinator i Programit të Studimit, edhe me komunikim joformal, të paktën 30 ditë pune para çdo sezoni diplomimi.

Në përfundim të seancës së Diplomimit, Sekretaria Mësimore e UKZKM i transferon, secilit të diplomuar, Sekretarisë Studentore UNIFI / DIDA një kopje të procesverbalit të seancës së diplomimit në italisht, një pagesë që korrespondon me dy pulla detyrimesh, dhe çdo dokument tjetër që mund të kërkohet për dhënien e diplomës së dëfistë nga UNIFI.

UNIFI, për secilin të diplomuar do të marrë dokumentacionin e plotë dhe pasi të verifikojë të dhënat, do t'i dërgojë pergamenat e Diplomave në Sekretarinë Mësimore të UKZKM i cili do t'i dërgojë ato tek të interesuarit.

Data, 7 Maj 2020

Rektori

Prof. Bruno Giardina





UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

FACOLTÀ DELLE SCIENZE APPLICATE

Programi i Studimit Master i Shkencave në _____

(Kërkesa për caktimin e temës duhet të paraqitet 6 muaj para seancës së diplomimit)

Dekanit

të Fakultetit

Unë i/e nënshkruari/a _____

Lindur në _____ të _____

Banues _____ në rrugën _____

Regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në _____ V.Ak.

Kërkoj të mund të përpunoj temën e diplomës në një nga disiplinat vijuese :

1) _____

2) _____

3) _____

Tiranë më, _____

Firma e studentit _____

FORMULAR 1





UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

FACOLTÀ DELLE SCIENZE APPLICATE

Kërkesë për diplomim

Drejtuar: REKTORIT TË NDERUAR
TE UNIVERSITETIT KATOLIK
"NSBC" TIRANA

Nr. i Matrikullës _____

____ I/e nënshkruari/a _____ lindur në _____ më _____

banues në _____ në rrugën _____ tel. _____

I regjistruar _____ në V.Ak. _____/_____ më _____ viti në vijim/jashte programit të studimit Master i
Shkencave në _____ të Fakultetit të _____

_____ pasi ka punuar nën drejtimin e prof.

Relator _____ temën e diplomës

(specifiko lëndën) _____

me titull _____

Firma e Relatorit _____

Firma e Bashkë-Relatorit _____

KËRKON:

a) të pranohet për të mbrojtur provimin e masterit në sezonin _____ të vitit akademik _____

b) t'i lëshohet diploma origjinale sapo të jetë gati

c) t'i kthehet diploma origjinale e shkollës së mesme e depozituar në zyrat tuaja.

I nënshkruari deklaron, nën përgjegjësinë e tij, se nuk ka libra dhe materiale që i përkasin Universitetit në posedim.

Tiranë më, _____

Firma e studentit _____

Bashkëlidhur:
Libreza e universitetit

FORMULAR 2





UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

FACOLTÀ DELLE SCIENZE APPLICATE

DEKLARATË

Deklaroj që studenti/ja.....ka përfunduar punimin e temës me titull

“

..... ” dhe për këtë arsye, është gati për datën e radhës të diplomimit.

Data

Firma

Prof.





UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



UNIVERSITÀ
DEGLI STUDI
FIRENZE
DIDA
DIPARTIMENTO DI
ARCHITETTURA

FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA

PROGRAMI I STUDIMIT NË ARKITEKTURË

Tema e diplomës
në
...(book antiqua style 16) shembull: GRAFIKË DIGJITALE

TITULLI

... (book antiqua style 16)...

RELATORI

PROF. _____

BASHKË-RELATORI

PROF. _____

STUDENTI

Matr. ZO....

Viti akademik 2019– 2020



Deklarohet se ky përkthim është i njëjtë me tekstin original në gjuhën italiane dhe se është kryer nga “Xhuljeta Kasmollari”, përkthyesë e njohur dhe akredituar pranë Ministrisë së Drejtësisë shqiptare.



A handwritten signature in blue ink, consisting of a series of loops and strokes, located in the bottom right corner of the page.